



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organ i Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Duke ju referuar kompetencave të parapara me nenin 98, 98 lidhur me nenin 104 dhe 105, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), Organ i Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), publikon:

INFORMIM PUBLIK

[me interes për operatorët ekonomik]

Secili OE i cili ushtron ankesë në OSHP, duhet ta dëshmoj statusin e *palës me interes* për aktivitetin përkatës të prokurimit, sikurse është përkufizuar me nenin 4, parografi 1, nën-parografi 26, (shprehja "palë e interesuar") lidhur me paragrin 1, nën-parografi 5, të nenit 111, të LPP.

Nëse në përbajtjen e ankeses nuk dëshmohet se OE nga cilësia e tij/sajë si ankues, ka interes juridiko-material për aktivitetin përkatës të prokurimit për të cilin ushtrohet ankesa, OSHP ka të drejtë që ankesën ta hedhë si të palejuar, kurse shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore konfiskohet dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sipas nenit 31, parografi 1, të Rregullores së punës të OSHP.

Po ashtu, Duke ju referuar nenit 1, të LPP, sipas të cilit qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritetin e procesit të prokurimit publik si dhe të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, etike dhe të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike dhe duke iu përbajtur parimeve themelore të këtij ligji, OSHP, informom ankuesit po ashtu se:

Pavarësisht, statusit të ankuesit (*si palë me apo pa interes-juridiko-material*), OSHP ka të drejtë (natyrisht pa paragjykim), ta refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe është i obliguar të urdhëroj konfiskimin e tarifës ankimore sipas nenit 118 të LPP, lidhur me nenin 31, të Rregullores së cituar, apriori në rastet si në vijim:

- a) Nëse ankuesi nuk prezanton asnjë fakt apo fakte dhe provë përkitazi me vertetimin e fakteve të pohuara se nuk qëndron dhe/ose është kundërligjor vlerësimi, respektivisht akti i atakuar i AK për eliminimin e tij/sajë dhe/ose nuk e argumenton faktin/pohimin bazë, se është i përgjegjshëm për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ushtruar ankesë;
- b) Nëse ankuesi është renditur i 2-ti; 3-treti; 4-katërti, tutje (në radhitje) në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tendereve (neni 59) i njofuar zyrtarisht nga AK me anë të Letrës standarde për tenderuesin e pa-suksesshëm dhe i njëjtë nuk e argumenton pohimin se është i përgjegjshëm, kurse OE të tjerë (të radhitur më lartë) dhe/ose OE i rekomanduar nuk janë të përgjegjshëm;

OSHP kujton se:

Sipas nenit 7, të LPP, secili autoritet kontraktues është i obliguar që ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese, do të veprojë në mënyrë transparente dhe nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në atë mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën e lirë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik dhe se, secili autoriteti kontraktues është i obliguar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Megjithatë,

Bazuar në parimet e etikës profesionale dhe kodit etik të prokurimit për ti shmangur kostot e panevojshme, OSHP e konsideron të nevojshme dhe të duhur të informoj OE, se sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, në të gjitha rastet e shpjeguara si më sipër, apriori ankesat do te hedhen si të pa lejuara dhe për rrjedhojë mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore konfiskohen, të cilat i kalojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 02.02.2023